

VENDIM
Nr. 669, datë 3.10.2012

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 520, DATË 1.8.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË FORMËS SË ORGANIZIMIT DHE TË STATUTIT TË
QENDRËS “ECAT TIRANA” DHE PËR KONTRIBUTIN E QEVERISË SHQIPTARE PËR KËTË
QENDËR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 520, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e ndryshimit të formës së organizimit dhe të statutit të qendrës “ECAT Tirana” dhe për kontributin e qeverisë shqiptare për këtë qendër”.

2. Funksionimi i qendrës “ECAT Tirana” t’i nënshtrohet ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha